

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Profilin Mësimor

SHËRBIME NË MJETET E RËNDA
TË TRANSPORTIT

Niveli III i KSHK

(1 vjeçar)

**(Në drejtimin mësimor “Shërbime mjetesh
transporti”)**

Kodi: M5-III-20

Miratoi:

MINISTRI

Tiranë, 2020

Përmbajtja:

I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Shërbime në mjetet e rënda të transportit”, niveli III i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), të drejtimit mësimor “Shërbime mjetesh transporti”.

III I KSHK. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Shërbime në mjetet e rënda të transportit”, niveli III i KSHK.

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Shërbime në mjetet e rënda të transportit”, niveli III I KSHK
2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Shërbime në mjetet e rënda të transportit”, niveli III i KSHK
3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Shërbime në mjetet e rënda të transportit”, niveli III i KSHK
4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në në profilin “Shërbime në mjetet e rënda të transportit”, niveli III i KSHK

III. Plani mësimor për profilin “Shërbime në mjetet e rënda të transportit”, niveli III i KSHK.

IV. Udhëzime për planin mësimor

V. Udhëzime për procesin mësimor.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në profilin “Shërbime në mjetet e rënda të transportit”, niveli III i KSHK,

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.

X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.

I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Shërbime në mjetet e rënda të transportit”, niv. III i KSHK, të drejtimit “Shërbime mjetesh transporti”.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Shërbime në mjetet e rënda të transportit”, niveli III i KSHK, të drejtimit “Shërbime mjetesh transporti”, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me shërbimet në mjetet e rënda të transportit”*. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Shërbime në mjetet e rënda të transportit”, niveli III i KSHK

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Shërbime në mjetet e rënda të transportit”, niveli III i KSHK

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor “Shërbime në mjetet e rënda të transportit” niveli III i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “Shërbime mjetesh transporti”, niveli II i KSHK;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MFE përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim të arsimit në profilin “Shërbime në mjetet e rënda të transportit”, niveli III i KSHK

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Shërbime në mjetet e rënda të transportit”, niveli III i KSHK, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.



- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efikente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin mësimor “Shërbime në mjetet e rënda të transportit”, niveli III i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Shërbime në mjetet e rënda të transportit”, niveli III i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në nivelin II të KSHK, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të konceptojë planin për hapjen e një biznesi të vogël për shërbimet në mjetet e rënda të transportit.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me shërbimet në mjetet e rënda të transportit.
- Të zbatojë standardet e profesionit.
- Të lexojë, interpretojë dhe plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për shërbimet në mjetet e rënda të transportit.
- Të organizojë vendin e punës për kryerjen e shërbimeve në mjetet e rënda të transportit.
- Të përzgjedhë veglat, pajisjet, instrumentet dhe materialet e duhura për kryerjen e shërbimeve në mjetet e rënda të transportit.
- Të kryejë kontrollet dhe matjet e nevojshme për shërbimet në mjetet e rënda të transportit.
- Të përdorë dhe mirëmbajë veglat, pajisjet dhe instrumentet e punës.
- Të bëjë diagnostimin e parregullsive në agregatet, sistemet dhe mekanizmat e mjeteve të rënda të transportit.
- Të kryejë mirëmbajtjen dhe riparimin e motorëve të mjeteve të rënda të transportit.
- Të kryejë mirëmbajtjen dhe riparimin e pjesëve xhenerike të automjeteve të rënda.
- Të kryejë mirëmbajtjen dhe riparimin e karrocërisë së mjeteve të rënda të transportit.
- Të kryejë mirëmbajtjen dhe riparimin e agregatëve të mjeteve të rënda të transportit.
- Të komunikojë me etikën e duhur në kuadrin e veprimtarive profesionale.
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit.

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në profilin “Shërbimet në mjetet e rënda të transportit”, niveli III i KSHK.



Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin “Shërbimet në mjetet e rënda të transportit”, niveli III i KSHK, e pajis nxënësin me certifikatën e punonjësit të kualifikuar në këtë profil profesional. Ky arsimim i jep mundësi nxënësit t’i drejtohet tregut të punës në ndërmarrje/servise të ndryshme që kryejnë shërbime të mirëmbajtjes dhe riparimit në mjetet e rënda të transportit, si dhe në dyqane që tregtojnë pjesë këmbimi për këto mjete. Gjithashtu, me përvojë pune të mëtjshme, nxënësi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual ose të krijojë biznesin e tij në fushën e shërbimeve në mjetet e rënda të transportit. Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin IV të KSHK teknik/manaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin “Shërbime mjetesh transporti”, për të fituar diplomën e “Maturës shtetërore profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare dhe pas të mesmes.

III I KSHKI. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin mësimor “Shërbime në mjetet e rënda të transportit”, niveli III i KSHK

Plani mësimor për profilin mësimor “Shërbime në mjetet e rënda të transportit”, niveli III i KSHK			
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/vjetore
			Klasa 12
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	8/9 (272/306)
1		Gjuhë shqipe	1
2		Letërsi	1
3		Gjuhë e huaj e parë	2
4		Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(1)
5		Matematikë	2
6		TIK	1
7		Edukim fizik, sporte, shëndet	1
B.		Lëndët profesionale (Gjithsej)	7 (238)
1	L-17-157-20	Bazat e sipërmarrjes	2
2	L-18-436-16	Njohuri për mjetet e rënda të transportit	2
3	L-18-437-16	Shërbimet në mjetet e rënda të transportit	3
C.		Module të detyruar të praktikës profesionale (Gjithsej)	12 (408)
1	M-18-1327-16	Shërbimet e motorit në mjetet e rënda të transportit	84
2	M-18-1328-16	Shërbimet xhenerike në mjetet e rënda të transportit	120
3	M-18-1329-16	Shërbimet e karrocërisë në mjetet e rënda të transportit	84
4	M-18-1330-16	Shërbimet në agregatet e mjeteve të rënda të transportit	120
D.		Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar (Gjithsej)	3 (102)
1	M-18-1331-16	Shërbimet në vinçat hidraulikë të montuar në mjetet e rënda të transportit	102
2	M-18-1332-16	Shërbimet në sistemin hidraulik për ngritje të platformës të kamionit	102
		Gjithsej A+B+C+D	30/31



			(1020/ 1054)
--	--	--	-----------------

IV. Udhëzime për planin mësimor

Kohëzgjatja e vitit shkollor është:

Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 2 javë provime)

Një javë mësimore ka jo më shumë se 31 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në profilin “Shërbime në mjetet e rënda të transportit”, niveli III i KSHK, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASR).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithëshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që *planifikimi i mësimdhënies* të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritetit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënësit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të profilit mësimor “Shërbime në mjetet e rënda të transportit”, niveli III i KSHK.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehjet praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimin (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënësit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna

kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të profilit profesional “Shërbime në mjetet e rënda të transportit”.

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë dhe të krijojnë kushte për zbatim.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 12-të, nxënësi i arsimuar në profilit mësimor “Shërbime në mjetet e rënda të transportit”, niveli III i KSHK, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;
- b) Provimi i praktikës profesionale të integruar;

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e ndërtimit, dhe u jepet certifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme, si dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit III i KSHK.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në profilit mësimor “Shërbime në mjetet e rënda të transportit”, niveli III i KSHK

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në profilit mësimor “Shërbime në mjetet e rënda të transportit”, niveli III i KSHK, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Dëftesën e përfundimit të këtij niveli si dhe me Certifikatën e aftësisimit profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:
 - rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale;
 - rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit III të KSHK.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-157-20). Kl. 12 – 68 orë

– Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12, nxënësit duhet:

- të përshkruajnë kuptimin, rëndësinë dhe rolin e sipërmarrjes në kontekstin individual dhe shoqëror
- të përshkruajnë veçoritë e sjelljes sipërmarrëse të individëve
- të analizojnë aftësitë dhe mundësitë personale në kontekstin e nismave sipërmarrëse
- të bëjnë vlerësimin e kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive të tyre për karrierën e ardhëshme
- të zbatojnë procedurat për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve të duhura në lidhje me to.
- të mbajnë qëndrim kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve të mundshme
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e etikës së komunikimit dhe negocimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e punës individuale dhe të punës në grup
- të analizojnë veçoritë e gatishmërisë, iniciativës dhe motivimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të tregojnë përgjegjësi individuale dhe shoqërore në kontekste të ndryshme jetësore
- të planifikojnë, sigurojnë dhe përdorin me efikasitet burimet e ndryshme si mjedisin, burimet njerëzore, paratë, kohën etj.
- të përshkruajnë veçoritë dhe kërkesat për udhëheqjen e sipërmarrjeve të ndryshme
- të përshkruajnë veçoritë dhe impaktin e globalizimit, informacionit, mjedisit dixhital dhe mediave sociale në shoqërinë e sotme dhe të së ardhmes
- të përshkruajnë veçoritë e sipërmarrjes së biznesit dhe të sipërmarrjes sociale
- të përshkruajnë format e ndryshme të organizimit të sipërmarrjeve dhe karakteristikat e tyre
- të analizojnë faktorët që ndikojnë në veprimtarinë e sipërmarrjeve, të tillë si tregjet, klientela, konkurrenca, kostot etj.
- të përshkruajnë mjedisin ligjor dhe fiskal të sipërmarrjeve
- të përshkruajnë mërrëdhëniet e punës në një sipërmarrje.

• Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12 - 68 orë

Tema 1	Kuptimi, rëndësia dhe roli i sipërmarrjes	3 orë
Tema 2	Aftësitë dhe sjellja sipërmarrëse	3 orë
Tema 3	Vetvlerësimi i potencialit personal	3 orë
Tema 4	Vlerësimi i kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive	4 orë
Tema 5	Zgjidhja e problemeve dhe vendimmarrja	4 orë
Tema 6	Qëndrimi kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve	3 orë
Tema 7	Etika e komunikimit dhe negocimit	4 orë
Tema 8	Puna individuale dhe puna në grup	4 orë



Tema 9	Gatishmëria, iniciativa dhe motivimi	3 orë
Tema 10	Përgjegjësia individuale dhe shoqërore	3 orë
Tema 11	Menaxhimi eficient i burimeve	3 orë
Tema 12	Aftësitë udhëheqëse në kontekstin e sipërmarrjes	3 orë
Tema 13	Globalizimi, informacioni, mjedisi dixhital dhe mediat sociale	5 orë
Tema 14	Sipërmarrja e biznesit dhe sipërmarrja sociale	3 orë
Tema 15	Format e organizimit të sipërmarrjeve	5 orë
Tema 16	Konteksti i sipërmarrjeve, tregjet, klientela, konkurenca, kostot etj.	6 orë
Tema 17	Mjedisi ligjor i sipërmarrjeve	5 orë
Tema 18	Marrëdhëniet e punës	4 orë

2. Lënda “Njohuri për mjetet e rënda të transportit” (L-18-436-16). Kl. 12 – 68 orë

• Synimet e lëndës “Njohuri për mjetet e rënda të transportit”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Njohuri për mjetet e rënda të transportit”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të tregojnë se ç’janë mjetet e rënda të transportit dhe të argumentojnë rëndësinë dhe qëllimin e tyre.
- Të bëjnë klasifikimin e mjeteve të rënda të transportit dhe të tregojë veçoritë e tyre.
- Të përshkruajnë ndërtimin dhe funksionimin e makinave gërmuese (fadromave dhe eskavatorëve).
- Të përshkruajnë ndërtimin dhe funksionimin e makinave gërmuese dhe transportuese.
- Të përshkruajnë ndërtimin dhe funksionimin e makinave liveluese (grejderave).
- Të përshkruajnë ndërtimin dhe funksionimin e makinave të rënda transportuese.
- Të ndërtojë skemën kinematike të agregateve dhe të shpjegojë ndërtimin dhe funksionimin e tyre.
- Të përshkruajnë sistemin e frenimit pneumatik dhe hidropneumatik në mjetet e rënda të transportit.
- Të përshkruajnë ndërtimin e sistemit hidraulik të agregateve dhe të ndërtojë skemën kinematike të tij.
- Të përshkruajnë veçoritë e platformës mbajtëse në mjetet e rënda të transportit.
- Të përshkruajnë veçoritë e mjeteve lëvizëse me zinxhir.
- Të përshkruajnë ndërtimin dhe funksionimin e hidromotorit, pompës hidraulike dhe shpërndarësve hidraulikë.
- Të përshkruajnë ndërtimin dhe funksionimin e pajisjes ngritëse në makinat transportuese dhe makinat vetshkarkuese.

• Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Njohuri për mjetet e rënda të transportit”, kl. 12 - 68 orë:

Tema 1	Njohuri të përgjithshme për mjetet e rënda të transportit.	2 orë
Tema 2	Klasifikimi dhe veçoritë e mjeteve të rënda të transportit.	3 orë
Tema 3	Ndërtimi dhe funksionimi i makinave gërmuese (fadromat dhe eskavatorët).	4 orë
Tema 4	Ndërtimi dhe funksionimi i makinave gërmuese dhe transportuese.	4 orë

Tema 5	Ndërtimi dhe funksionimi i makinave liveluese (grejderave).	4 orë
Tema 6	Ndërtimi dhe funksionimi i makinave të rënda transportuese (vetëshkarkuese).	4 orë
Tema 7	Skema kinematike e agregateve të mjeteve të rënda të transportit, ndërtimi dhe funksionimi.	4 orë
Tema 8	Platforma mbajtëse dhe mekanizmi i rrotullimit të saj (mekanizmi koronë - pinjon) në makinat e rënda transportuese, ndërtimi dhe funksionimi.	8 orë
Tema 9	Sistemi i frenimit dhe veçoritë e tij në mjetet e rënda të transportit. Sistemi i frenimit pneumatik dhe hidropneumatik.	6 orë
Tema 10	Ndërtimi i sistemit hidraulik në mjetet e rënda të transportit, funksionimi dhe pjesët përbërëse të tij (shpërndarësit, tubacionet e transmetimit të lëngut hidraulik, shtytësit hidraulik, lëngu hidraulik etj.).	8 orë
Tema 11	Skema kinematike e sistemit hidraulik.	2 orë
Tema 12	Veçoritë e mjeteve lëvizëse me zinxhir, ndërtimi dhe funksionimi.	4 orë
Tema 13	Hidromotori, ndërtimi dhe funksionimi.	4 orë
Tema 14	Pompa hidraulike, ndërtimi dhe funksionimi.	4 orë
Tema 15	Ndërtimi dhe funksionimi i pajisjes ngritëse në makinat transportuese.	4 orë
Tema 16	Ndërtimi dhe funksionimi i pajisjes ngritëse në makinat vetëshkarkuese.	3 orë

3. Lënda “Shërbimet në mjetet e rënda të transportit” (L-18-437-16). Kl. 12 – 102 orë

- **Synimet e lëndës “Shërbimet në mjetet e rënda të transportit”, kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Shërbimet në mjetet e rënda të transportit”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të tregojnë se ç’janë shërbimet në mjetet e rënda të transportit dhe të argumentojnë rëndësinë e tyre.
- Të bëjnë klasifikimin e shërbimeve në mjetet e rënda të transportit.
- Të përshkruajnë ndërtimin dhe funksionimin e një servisi për shërbimet në mjetet e rënda të transportit.
- Të dallojnë dhe tregojnë përdorimet e veglave, instrumenteve dhe pajisjeve të punës në një servis për shërbimet në mjetet e rënda të transportit.
- Të përshkruajnë si bëhet organizimi i punës në një servis për shërbimet në mjetet e rënda të transportit.
- Të tregojnë masat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit në shërbimet në mjetet e rënda të transportit.
- Të përdorin informacionin dhe dokumentacionin teknik për shërbimet në mjetet e rënda të transportit.
- Të përshkruajnë parregullsitë kryesore në motorr, transmision, sistemin e ecjes, sistemin e drejtimit, sistemin e frenimit, karrocerinë e agregatet e mjeteve të rënda të transportit, si dhe shkaqet e tyre.
- Të përshkruajnë procedurat e diagnostikimit të parregullsive në motorr, transmision, sistemin e ecjes, sistemin e drejtimit, sistemin e frenimit, karroceri dhe në agregatet e mjeteve të rënda të transportit.
- Të përshkruajnë procedurat e mirëmbajtjes së motorrit, transmisionit, sistemit të ecjes, sistemit të drejtimit, sistemit të frenimit, karrocervisë dhe agregateve të mjeteve të rënda të



transportit.

- Të përshkruajnë procedurat e riparimeve të llojeve të ndryshme në motorr, transmision, sistemin e ecjes, sistemin e drejtimit, sistemin e frenimit, karroceri dhe agregate të mjeteve të rënda të transportit.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Shërbimet në mjetet e rënda të transportit”, kl. 12 - 102 orë:**

Tema 1	Njohuri të përgjithshme për shërbimet në mjetet e rënda të transportit. Punësimet dhe profesionet përkatëse.	2 orë
Tema 2	Klasifikimi dhe veçoritë e shërbimeve në mjetet e rënda të transportit.	2 orë
Tema 3	Ndërtimi dhe funksionimi i një servisi për shërbimet në mjetet e rënda të transportit	2 orë
Tema 4	Veçat, instrumentet dhe pajisjet e punës në një servis për shërbimet në mjetet e rënda të transportit	3 orë
Tema 5	Organizimi i punës në një servis për shërbimet në mjetet e rënda të transportit	2 orë
Tema 6	Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në shërbimet në mjetet e rënda të transportit.	2 orë
Tema 7	Përdorimi i informacionit dhe dokumentacionit teknik në shërbimet në mjetet e rënda të transportit. Katalogët e pjesëve të këmbimit	2 orë
Tema 8	Procedura e çmontimit dhe e montimit të motorit	2 orë
Tema 9	Diagnostikimi, mirëmbajtja dhe riparimi i trupit të motorit (testatë dhe blloku i cilindrave)	2 orë
Tema 10	Diagnostikimi, mirëmbajtja dhe riparimi i mekanizmit bjellë-manivelë dhe mekanizmit të shpërndarjes së gazeve të motorit.	4 orë
Tema 11	Diagnostikimi, mirëmbajtja dhe riparimi i sistemit të vajisjes dhe sistemit të ftohjes së motorit.	4 orë
Tema 12	Diagnostikimi, mirëmbajtja dhe riparimi i elementeve të sistemit të ushqimit të motorit “diesel”.	2 orë
Tema 13	Diagnostikimi, mirëmbajtja dhe riparimi i sistemit të shkarkimit të produkteve të djegies.	2 orë
Tema 14	Diagnostikimi, mirëmbajtja dhe riparimi i baterisë. Testet e baterisë	3 orë
Tema 15	Diagnostikimi, mirëmbajtja dhe riparimi i sistemit të karikimit alternator-rregullator.	2 orë
Tema 16	Diagnostikimi, mirëmbajtja dhe riparimi i sistemit të lëshimit të motorit	2 orë
Tema 17	Diagnostikimi, mirëmbajtja dhe riparimi i friksioneve mekanikë dhe hidraulike	2 orë
Tema 18	Diagnostikimi, mirëmbajtja dhe riparimi i kutive manuale dhe automatike të ndërrimit të shpejtësisë.	4 orë
Tema 19	Diagnostikimi, mirëmbajtja dhe riparimi i transmisioneve kardanike.	2 orë
Tema 20	Diagnostikimi, mirëmbajtja dhe riparimi i transmisioneve kryesore	2 orë
Tema 21	Diagnostikimi, mirëmbajtja dhe riparimi i diferencialeve dhe gjysmëboshteve	2 orë
Tema 22	Diagnostikimi, mirëmbajtja dhe riparimi i askseve të mjeteve të rënda të transportit.	2 orë
Tema 23	Diagnostikimi, mirëmbajtja dhe riparimi i varëseve të mjeteve të rënda të transportit.	4 orë
Tema 24	Diagnostikimi, mirëmbajtja dhe riparimi i rotave të mjeteve të rënda të	4 orë



	transportit. Balancimi dhe regjistrimi i këndeve të rrotave	
Tema 25	Diagnostikimi, mirëmbajtja dhe riparimi i sistemit të drejtimit.	4 orë
Tema 26	Diagnostikimi, mirëmbajtja dhe riparimi i sistemit të frenimit hidraulik.	2 orë
Tema 27	Diagnostikimi, mirëmbajtja dhe riparimi i sistemit të frenimit pneumatik	2 orë
Tema 28	Diagnostikimi, mirëmbajtja dhe riparimi i frenave të dorës	2 orë
Tema 29	Diagnostikimi, mirëmbajtja dhe riparimi i elementëve të karrocërisë së mjeteve të rënda të transportit	4 orë
Tema 30	Diagnostikimi, mirëmbajtja dhe riparimi i dyerve në mjetet e rënda të transportit	2 orë
Tema 31	Diagnostikimi, mirëmbajtja dhe riparimi i kolonave të dyerve në mjetet e rënda të transportit;	2 orë
Tema 32	Diagnostikimi, mirëmbajtja dhe riparimi (ose zëvendësimi) i mekanizmave të komandimit të xhamave, të pasqyrave dhe fshirëseve të xhamave, në mjetet e rënda të transportit	4 orë
Tema 33	Diagnostikimi, mirëmbajtja dhe zëvendësimi i parafangove, parakolpeve, tapicerisë, kroskotit dhe pjesëve të tjera plastike ose metalike në mjetet e rënda të transportit.	4 orë
Tema 34	Diagnostikimi, mirëmbajtja dhe riparimi i sistemit hidraulik të komandimit të organeve punuese të agregateve në mjetet e rënda të transportit	4 orë
Tema 35	Diagnostikimi, mirëmbajtja dhe riparimi i pompës hidraulike të agregatit të mjeteve të rënda të transportit	2 orë
Tema 36	Diagnostikimi, mirëmbajtja dhe riparimi i hidromotorit në mjetet e rënda të transportit	2 orë
Tema 37	Diagnostikimi, mirëmbajtja dhe riparimi i shpërndarësve hidraulikë në mjetet e rënda të transportit	2 orë
Tema 38	Diagnostikimi, mirëmbajtja dhe riparimi i cilindrave hidraulikpunues në mjetet e rënda të transportit	2 orë
Tema 39	Diagnostikimi, mirëmbajtja dhe riparimi me saldim i elementëve metalikë të dëmtuara të (kovës, thikës etj.) në mjetet e rënda të transportit	2 orë
Tema 40	Procedurat e shërbimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të strukturës metalike (kollonës kryesore, krahëve punues, kovës, thikës etj.) në mjetet e rënda të transportit	2 orë

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

1. Moduli “Shërbimet e motorit në mjetet e rënda të transportit”

Drejtimi: Shërbime mjetesh transporti
Profili: Shërbime në mjetet e rënda të transportit
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	SHËRBIMET E MOTORIT NË MJETET E RËNDA TË TRANSPORTIT	M-18-1327-16
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer punime të diagnostikimit, mirëmbajtjes dhe riparimit në mekanizmat dhe sistemet e motorëve të mjeteve të rënda të transportit.	
Kohëzgjatja e modulit	84 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Shërbime mjetesh transporti”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi kryen punime të mirëmbajtjes dhe riparimit në mekanizmin bjellë-manivelë të motorit të mjetit të rëndë. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të analizojë dokumentacionin teknik të motorit.– të përgatitë vendin e punës për punime në mekanizmin bjellë-manivelë.– të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe instrumentet për punime në mekanizmin bjellë-manivelë.– të vendosë në mënyrë të sigurtë automjetin në postin e punës.– të marrë informacion paraprak për parregullsitë në mekanizmin bjellë-manivelë të motorit.– të çmontojë lidhjet e motorit me agregatet tjera dhe motorin nga automjeti (nëse është e nevojshme), si dhe ta pastrojë e lajë atë.– të vendosë motorin në bangon e punës.– të kryejë matje dhe kontrole paraprake për përcaktimin paraprak të parregullsive të motorit.– të zbrazë vajin nga motori.– të bëjë çmontimin e kokës së motorit, guarnicionit të kokës, nënkarterit, nyjes piston-bjellë dhe elementeve të saj, permistopave dhe rrotës me dhëmbë të	

- shpërndajes, qafave të bangove, kushinetave, boshtit motorik, volantit dhe këmishave.
- të bëjë pastrimin e dhomave të djegies, sipërfaqes së kokës së motorit dhe sipërfaqes së bllokut të cilindrave.
 - të kryejë matjet, kontrollet dhe të përcaktojë parregullsitë e kokës së motorit, të elementeve të nyjes piston-bjellë, të qafave të boshtit motorik, të bangove, të kushinetave (bronxinave), të këmishave.
 - të llogaritë përmasat riparuese të këmishave të cilindrave dhe qafave të boshtit motorik.
 - të zbatojë procedurën e pastrimit të vrimave dhe kanaleve të kalimit të vajit, të kanaleve e dhomave të kalimit të lëngut ftohës, në bllokun e cilindrave;
 - të bëjë montimin e këmishave të reja (nëse duhet të zëvendësohen), volantit, boshtit motorik, kushinetave, qafave të bangove, elementeve të mekanizmit bjellë-manivelë, permistopave dhe rrotës me dhëmbë të shpërndajes, guarnicionit dhe kokës së motorit, guarnicionit dhe nënkarterit të motorit.
 - të kryejë montimin e lidhjeve dhe pjesëve të çmontuara nga koka dhe trupi i motorit.
 - të hedhë vajin në nënkarterin e motorit.
 - të kryejë provën e funksionimit të pjesëve të riparuar ose të zëvendësuara të mekanizmit bjellë manivelë.
 - të përdorë dokumentacionin teknik (katalogëve) për të përzgjedhur pjesët e mekanizmit bjellë manivelë që do të zëvendësohen.
 - të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës.
 - të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për shërbimet e kryera.
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mirëmbajtjes dhe riparimit të mekanizmit bjellë-mainvelë të motorit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Nxënësi kryen punime të mirëmbajtjes dhe riparimit në mekanizmin e shpërndarjes së gazeve të motorit të mjetit të rëndë.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të analizojë dokumentacionin teknik të motorit të mjetit të rëndë.
- të përgatitë vendin e punës për punime në mekanizmin e shpërndarjes së gazeve.
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe instrumentet për punime në mekanizmin shpërndarjes së gazeve.
- të vendosë në mënyrë të sigurtë automjetin në postin e punës.



- të marrë informacion paraprak për parregullsitë në mekanizmin shpërndarjes së gazeve të motorit.
- të heqë kapakun e valvolave dhe kapakun e rrotave të dhëmbëzuara ose zinxhirit të shpërndarjes.
- të bëjë kontrollin pamor-dëgjimor i funksionimit të mekanizmit të shpërndarjes së gazeve dhe përcaktimi i parregullsive.
- të bëjë kontrollin dhe matjen e hapësirave termike midis bishtave të valvolave dhe elementeve që transmetojnë lëvizjen, si dhe të përcaktojë parregullsitë.
- të bëjë çmontimin e nyjeve të valvolave.
- të bëjë çmontimin e elementeve që transmetojnë lëvizjen nga boshti me gunga te bishtat e valvolave.
- të bëjë heqjen e zinxhirit të shpërndarjes (kur ka të tillë).
- të bëjë çmontimin e rrotës me dhëmbë (ose rrotës yll) të boshtit me gunga.
- të bëjë çmontimin e boshtit me gunga dhe elementeve të tij.
- të bëjë çmontimin e foleve (sedieve) dhe udhëzuesve (guidave) të valvolave (nëse është e nevojshme).
- të kryejë matjet dhe kontrollet e pjesëve të çmontuara, si dhe përcaktimi i parregullsive.
- të përzgjedhë pjesët e mekanizmit të shpërndarjes së gazeve që do të zëvendësohen.
- të bëjë montimin e foleve dhe udhëzuesve të valvolave.
- të bëjë frezimin dhe zmerilimin e foleve të valvolave (kur është e nevojshme).
- të bëjë montimin e boshtit me gunga dhe elementeve të tij.
- të bëjë montimin në bosht të rrotës me dhëmbë (ose rrotës yll) sipas shenjave të vënies në fazë.
- të bëjë montimin e elementeve që transmetojnë lëvizjen nga boshti me gunga te bishtat e valvolave.
- të bëjë montimin e nyjeve të valvolave.
- të bëjë vendosjen e zinxhirit të shpërndarjes (kur ka të tillë) dhe vendosja në fazë e mekanizmit të shpërndarjes së gazeve.
- të bëjë regjistrimin e hapësirave termike midis bishtave të valvolave dhe elementeve që transmetojnë lëvizjen (kur nuk janë vetëregjistruese).
- të bëjë kontrollin e funksionimit të mekanizmit të riparuar të shpërndarjes së gazeve dhe mënjanimin e parregullsive të mundshme.
- të bëjë montimin e kapakut të valvolave dhe kapakut të rrotave të dhëmbëzuara ose zinxhirit të shpërndarjes, si dhe gurnicioneve të tyre.
- të përdorë dokumentacionit teknik (katalogët) për të përzgjedhur pjesët e mekanizmit të shpërndarjes së gazeve që do të zëvendësohen.
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës.
- të plotësojë dokumentacion teknik dhe financiar për



shërbimet e kryera.

- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mirëmbajtjes dhe riparimit të mekanizmit të shpërndarjes së gazeve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi kryen punime të mirëmbajtjes dhe riparimit në sistemin e vajisjes së motorit të mjetit të rëndë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë drejt parregullsitë në sistemin e vajisjes së motorit të mjetit të rëndë.
- të përcaktojë saktë shkaqet e parregullsive të sistemit të vajisjes së të motorit
- të marrë masat e duhura për riparimin e parregullsive të sistemit të vajisjes së motorit.
- të komunikojë me profesionalizëm, të plotësojë si duhet dokumentacionin dhe të kryejë llogaritje të sakta ekonomike për diagnostikimin dhe riparimin e sistemit të vajisjes së motorit të automjetit.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Nxënësi kryen punime të mirëmbajtjes dhe riparimit në sistemin e ftohjes me ujë të motorit të mjetit të rëndë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë drejt parregullsitë në sistemin e ftohjes me ujë të motorit.
- të përcaktojë saktë shkaqet e parregullsive të sistemit të ftohjes me ujë të motorit të mjetit të rëndë.
- të marrë masat e duhura për riparimin e parregullsive të sistemit të ftohjes me ujë të motorit.
- të komunikojë me profesionalizëm
- të plotësojë si duhet dokumentacionin teknik
- të kryejë llogaritje të sakta ekonomike për diagnostikimin dhe riparimin e sistemit të ftohjes me ujë të motorit të mjetit të rëndë.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemit të ftohjes me ujë të motorit të mjetit të rëndë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 5 Nxënësi kryen punime të mirëmbajtjes dhe riparimit në sistemin e ushqimit të motorit “diesel” të mjetit të rëndë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë drejt parregullsitë në sistemin e ushqimit të motorit “diesel” të mjetit të rëndë.
- të përcaktojë saktë shkaqet e parregullsive të sistemit të ushqimit të motorit “diesel”.
- të marrë masat e duhura për riparimin e parregullsive të sistemit të ushqimit të motorit “diesel”.
- të komunikojë me profesionalizëm
- të plotësojë si duhet dokumentacionin teknik
- të kryejë llogaritje të sakta ekonomike për diagnostikimin dhe riparimin e sistemit të ushqimit të motorit “diesel” të mjetit të rëndë.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 6 Nxënësi kryen punime të mirëmbajtjes dhe riparimit në sistemet e thithjes dhe shkarkimit të produkteve të djegies së motorit të mjetit të rëndë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë drejt parregullsitë në sistemet e thithjes dhe shkarkimit.
- të përcaktojë saktë shkaqet e parregullsive në sistemet e thithjes dhe shkarkimit.
- të marrë masat e duhura për riparimin e parregullsive në sistemet e thithjes dhe shkarkimit.
- të komunikojë me profesionalizëm
- të plotësojë si duhet dokumentacionin
- të kryejë llogaritje të sakta ekonomike për mirëmbajtjen dhe riparimin e sistemeve të thithjes dhe shkarkimit në motor.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e ruajtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e shkollës për shërbime motorike ose në servise private të mjeteve të rënda.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të punimeve për shërbimet e mekanizmave e sistemeve të motorit të mjeteve të rënda të transportit.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve të matjes, kontrollit, riparimit, zëvendësimit dhe provës së mekanizmave e sistemeve të motorit, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë praktike që kryejnë.

-
- Instruktori duhet të përdorë metodën e simulimit të parregullsisve në pjesët e mekanizmave e sistemeve të motorit të mjeteve të rënda të transportit.
 - Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për kryerjen e shërbimeve të pjesët e motorit të mjeteve të rënda të transportit.
 - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Repart pune për shërbime motorike të mjeteve të rënda.
 - Motora në gjendje pune.
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për matje, kontrolle, zëvendësime dhe riparime të pjesëve të motorit të mjeteve të rënda.
 - Pjesë këmbimi për motorat e mjeteve të rënda.
 - Lubrifikues.
 - Katalogë të pjesëve të motorit, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

2. Moduli “Shërbimet xhenerike në mjetet e rënda të transportit”

Drejtimi: Shërbime mjetesh transporti
Profili: Shërbime në mjetet e rënda të transportit
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	SHËRBIMET XHENERIKE NË MJETET E RËNDA TË TRANSPORTIT	M-18-1328-16
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer punime të diagnostikimit, mirëmbajtjes dhe riparimit në pjesët xhenerike të mjeteve të rënda të transportit.	
Kohëzgjatja e modulit	120 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Shërbime mjetesh transporti”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi kryen punime të mirëmbajtjes dhe riparimit në friksionin e mjetit të rëndë. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të analizojë dokumentacionin teknik të friksionit të mjetit të rëndë.– të përgatitë vendin e punës për punime në friksionin e mjetit.– të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe instrumentet për punime në friksion.– të marrë informacionin paraprak për parregullsitë në friksion.– të kontrollojë dhe të provojë funksionimin e friksionit si dhe të përcaktojë parregullsitë.– të vendosë mjetin e rëndë në mënyrë të sigurtë në postin e punës.– të çmontojë lidhjet mekanike, hidraulike dhe elektrike të friksionit me agregatet tjera.– të çmontojë friksionin dhe mekanizmin e komandimit (mekanik dhe hidraulik) nga mjeti dhe të pastrojë atë.– të çmontojë pjesët e friksionit dhe mekanizmit të komandimit.– të kryejë kontrolle pamore dhe matje të pjesëve të çmontuara për përcaktimin e saktë të parregullsive.– të zëvendësojë dhe të montojë pjesë të dëmtuara të friksionit dhe mekanizmin e komandimit.– të kontrollojë dhe të rregullojë nivelin e alkoolit (dhe	

nxjerrjen e ajrit) të mekanizmit hidraulik të komandimit friksionit.

- të montojë friksionin dhe mekanizmin e komandimit (mekanik ose hidraulik) në mjet.
- të kryejë regjistrime në mekanizmin e komandimit (mekanik ose hidraulik), për mirëfunksionimin e friksionit.
- të kryejë grasatime në pjesët e friksionit të mjetit.
- të kryejë provën e funksionimit të pjesëve të riparuar ose të zëvendësuara të friksionit të mjetit.
- të përdorë dokumentacionin teknik (katalogët) për të përzgjedhur pjesët e friksionit që do të zëvendësohen.
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për shërbimet e kryera.
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mirëmbajtjes dhe riparimit të friksionit të mjetit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Nxënësi kryen punime të mirëmbajtjes dhe riparimit në kutinë manuale të ndërrimit të shpejtësisë në mjetin e rëndë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë dokumentacionin teknik të kutisë manuale të shpejtësisë së mjetit të rëndë.
- të përgatitë vendin e punës për punime në kutinë manuale të shpejtësisë.
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe instrumentet për punime në kutinë manuale të shpejtësisë.
- të marrë informacionin paraprak për parregullsitë në kutinë manuale të shpejtësisë.
- të kontrollojë dhe të provojë funksionimin e kutisë manuale të shpejtësisë dhe të përcaktojë parregullsitë.
- të vendosë mjetin e rëndë në postin e punës.
- të zbrazë vajin nga kutia manuale e shpejtësisë.
- të çmontojë lidhjet mekanike dhe elektrike të kutisë manuale të shpejtësisë, me agregatet tjera.
- të çmontojë kutinë manuale të shpejtësisë nga mjeti dhe agregatet e tjera (nëse është e nevojshme) dhe pastrimi i saj.
- të çmontojë pjesët e kutisë manuale të shpejtësisë dhe të mekanizmit të komandimit.
- të kryejë kontrolle pamore dhe matje të pjesëve të çmontuara për përcaktimin e saktë të parregullsive.
- të zëvendësojë dhe të montojë pjesë të dëmtuara të kutisë manuale të shpejtësisë dhe të mekanizmit të komandimit.

- të montojë kutinë manuale të shpejtësisë në mjet dhe me agregatet e tjera.
- të montojë lidhje mekanike dhe elektrike të kutisë manuale të shpejtësisë, me agregatet tjera.
- të rregullojë nivelin e vajit në kutinë manuale të shpejtësisë.
- të kryejë grasatime të kutisë manuale të shpejtësisë.
- të kryejë regjistrime në mekanizmin e komandimit të kutisë manuale të shpejtësisë.
- të kryejë provën e funksionimit të pjesëve të riparuar ose të zëvendësuara të kutisë manuale të shpejtësisë të automjetit.
- të përdorë dokumentacionin teknik (katalogët) për të përzgjedhur pjesët e kutisë manuale të shpejtësisë që do të zëvendësohen.
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për shërbimet e kryera.
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mirëmbajtjes dhe riparimit të kutisë manuale të shpejtësisë së mjetit të rëndë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi kryen punime të mirëmbajtjes në kutinë automatike të ndërrimit të shpejtësisë të mjetit të rëndë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë dokumentacionin teknik, të përgatitë vendin e punës, të përzgjedhë vegla, pajisje dhe instrumente për punime në kutinë automatike të ndërrimit të shpejtësisë.
 - të marrë informacion paraprak për parregullsitë kutisë automatike të ndërrimit të shpejtësisë.
 - të bëjë kontrollin dhe provën e funksionimit të kutisë automatike të shpejtësisë dhe përcaktimin e parregullsive
 - të vendosë mjetin në postin e punës.
 - të bëjë kontrollin pamor (për rrjedhje vaji) dhe kontrollin e nivelit të vajit të kutisë automatike të shpejtësisë.
 - të bëjë zbrazjen e vajit të kutisë automatike të shpejtësisë.
 - të bëjë çmontimin e kapakut, guarnicionit dhe filtrit të vajit të kutisë automatike të shpejtësisë.
 - të vendosë filtrin e ri të vajit.
 - të bëjë montimin e guarnicionit dhe kapakut të filtrit të vajit.
 - të bëjë hedhjen e vajit të ri dhe rregullimin e nivelit të duhur.
 - të bëjë çmontimin e pjesëve të mjetit që pengojnë heqjen e kutisë automatike të shpejtësisë.
 - të bëjë çmontimin e lidhjeve elektrike, mekanike, hidraulike dhe pneumatike të kutisë automatike të shpejtësisë.
 - të bëjë zbrazjen e vajit të kutisë automatike të shpejtësisë.
-

-
- të bëjë çmontimin e transmisionit kardanik nga boshti i daljes i kutisë automatike të shpejtësisë.
 - të bëjë çmontimin e bllokut të kutisë automatike të shpejtësisë nga trupi i motorit.
 - të bëjë çmontimin e këmbëve dhe heqjen e kutisë automatike të shpejtësisë.
 - të bëjë çmontimin dhe ndarjen e blloqeve kryesore dhe kapakëve të kutisë automatike të shpejtësisë.
 - të bëjë çmontimin e pjesëve të brendshme të kutisë automatike të shpejtësisë.
 - të bëjë kontrollin dhe matjen e pjesëve të çmontuara të kutisë automatike të shpejtësisë dhe përcaktimin e parregullsive.
 - të kryejë regjistrimet dhe shtrëngimet e ndryshme në kutinë automatike të ndërrimit të shpejtësisë.
 - të kryejë gratatimet e kutisë automatike të shpejtësisë.
 - të kryejë provën e funksionimit pas mirëmbajtjes së kutisë automatike të shpejtësisë të mjetit
 - të përdorë dokumentacionin teknik (katalogëve) për të përzgjedhur pjesët e kutisë automatike të shpejtësisë që do të zëvendësohen.
 - të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për shërbimet e kryera.
 - të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës.
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mirëmbajtjes dhe riparimit të kutisë automatike të shpejtësisë së mjetit të rëndë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Nxënësi kryen punime të mirëmbajtjes dhe riparimit në transmisionin kardanik, transmisionin kryesor, diferencialin dhe gjysëmboshtet e mjetit të rëndë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë dokumentacionin teknik, përgatitë vendin e punës, përzgjedhë veglat, pajisjet dhe instrumentet për punime në transmisionin kardanik, transmisionin kryesor, diferencialin dhe gjysëmboshtet e mjetit të rëndë
 - të marrë informacionin paraprak për parregullsitë e transmisionit kardanik, transmisionit kryesor, diferencialit dhe gjysëmboshteve.
 - të kontrollojë dhe të provojë funksionimin e transmisionit kardanik, transmisionit kryesor, diferencialit dhe gjysëmboshteve, si dhe të përcaktojë parregullsitë.
 - të vendosë mjetin e rëndë në postin e punës.
 - të zbrazë vajin nga kutia e diferencialit.
 - të ndajë transmisionin kardanik nga friksioni dhe
-

-
- transmisioni kryesor.
- të çmontojë pjesët e transmisionit kardanik
 - të çmontojë gjysëmboshtet.
 - të çmontojë pjesë të kutisë së transmisionit kryesor dhe diferencialit.
 - të kryejë kontrole pamore dhe matje të pjesëve të çmontuara për përcaktimin e saktë të parregullsive në transmisionin kardanik, diferencial, transmision kryesor dhe gjysëmboshte.
 - të zëvendësoj dhe të montojë pjesë të dëmtuara të transmisionit kardanik, transmisionit kryesor, diferencialit dhe gjysëmboshteve
 - të montojë pjesë të kutisë së transmisionit kryesor dhe diferencialit.
 - të montojë pjesët e transmisionit kardanik
 - të montojë gjysëmboshte.
 - të rregullojë nivelin e vajit në kutinë e transmisionit kryesor dhe diferencialit.
 - të kryejë grasatime në transmisionin kardanik, transmisionin kryesor, diferencial dhe gjysëmboshte.
 - të bëjë ballancimin e boshtit kardanik.
 - të kryejë provën e funksionimit të pjesëve të riparuar ose të zëvendësuara të transmisionit kardanik, transmisionit kryesor, diferencialit dhe gjysëmboshteve.
 - të përdorë dokumentacionin teknik (katalogët) për të përzgjedhur pjesët e transmisionin kardanik, transmisionit kryesor, diferencialit dhe gjysëmboshteve që zëvendësohen.
 - të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për shërbimet e kryera
 - të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës.
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mirëmbajtjes dhe riparimit të transmisionit kardanik, transmisionit kryesor, diferencialit dhe gjysëmboshteve të mjetit të rëndë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 5 Nxënësi kryen punime të mirëmbajtjes dhe riparimit në rrotat dhe sistemin e varjes së mjetit të rëndë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë dokumentacionin teknik të mjetit të rëndë.
- të përgatitë vendin e punës për punime në rrotat dhe sistemin e varjes së mjetit.
- të përzgjedhë vegla, pajisje dhe instrumente për punime në rrota dhe sistemin e varjes.
- të marrë informacionin paraprak dhe kontrollin pamor të parregullsive në rrota dhe në sistemin e varjes.
- të vendosë mjetin në postin e punës.



- të kontrollojë dhe të provojë paraprakisht funksionimin e rrotës dhe pjesëve të sistemit të varjes së mjetit.
- të çmontojë dhe të heqë rrotën nga mocoja.
- të çmontojë gomën nga disku dhe të kontrollojë atë.
- të riparojë gomën (nëse është e nevojshme).
- të kontrollojë diskun e rrotës.
- të montojë dhe të fryjë gomën.
- të ballancojë rrotën.
- të çmontojë mocon dhe kushinetën e rrotës dhe ti kontrollojë
- të zëvendësojë dhe të montojë kushinetën dhe mocon e rrotës.
- të kryejë gratatime.
- të montojë rrotën në moco.
- të çmontojë krahët, levat dhe shpatullat e sistemit të varjes së akseve të para dhe të prapme të mjetit.
- të çmontojë balestrat (spirale ose me fletë) e sistemit të varjes.
- të çmontojë amortizatorët, stabilizatorët, gominat dhe jastëkët e sistemit të varjes.
- të kontrollojë dhe të matë pjesë të çmontuara të sistemit të varjes dhe të përcaktojë parregullsitë.
- të zëvendësojë pjesë të dëmtuara të sistemit të varjes.
- të zbatojë procedurat e montimit të gominave, stabilizatorëve, amortizatorëve, balestrave, shpatullave, levave, krahëve dhe pjesëve të tjera të sistemit të varjes.
- të kryejë gratatime në pjesët e sistemit të varjes.
- të kryejë regjistrime në sistemin e varjes.
- të kryejë provën e funksionimit të pjesëve të riparuar ose të zëvendësuara të rrotave dhe sistemit të varjes.
- të përdorë dokumentacionin teknik (katalogët) për të për zgjedhur pjesët e rrotave dhe sistemit të varjes që do të zëvendësohen.
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për shërbimet e kryera.
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mirëmbajtjes dhe riparimit të rrotave dhe sistemit të varjes së mjetit të rëndë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 6 Nxënësi kryen punime të mirëmbajtjes dhe riparimit në sistemin e drejtimit të mjetit të rëndë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë dokumentacionin teknik të sistemit të drejtimit të mjetit të rëndë.



- të përgatitë vendin e punës për punime në sistemin e drejtimit të mjetit.
- të përzgjedhë vegla, pajisje dhe instrumente për punime në sistemin e drejtimit të mjetit.
- të marrë informacion paraprak për parregullsitë në sistemin e drejtimit të mjetit.
- të vendosë automjetin në postin e punës.
- të kontrollojë funksionimin e elementeve të sistemit të drejtimit, si dhe të bëjë përcaktimin e parregullsive.
- të bëjë çmontimin e pjesëve kryesore të sistemit të drejtimit (levat e kthimit, mekanizmin e kthimit, përforcuesin e sistemit të drejtimit, grupin e timonit).
- të bëjë çmontimin e detaleve të levave të kthimit, mekanizmit të kthimit, përforcuesit të sistemit të drejtimit, grupit të timonit.
- të kontrollojë dhe të matë pjesët e çmontuara dhe të përcaktojë parregullsitë e tyre.
- të përzgjedhë pjesët e duhura për zëvendësim.
- të bëjë montimin e detaleve të zëvendësuara të levave të kthimit, mekanizmit të kthimit, përforcuesit të sistemit të drejtimit, grupit të timonit.
- të bëjë montimin e pjesëve kryesore të sistemit të drejtimit (levat e kthimit, mekanizmin e kthimit, përforcuesin e sistemit të drejtimit, grupin e timonit).
- të kryejë gratatime.
- të bëjë regjistrimet e duhura në sistemin e drejtimit.
- të bëjë kontrollin e funksionimit të sistemit të drejtimit të riparuar.
- të kryejë prova në ecje të sistemit të drejtimit të mjetit të rëndë.
- të përdorë dokumentacionin teknik (katalogëve) për të përzgjedhur pjesët e sistemit të drejtimit që do të zëvendësohen.
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për shërbimet e kryera
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemit të drejtimit të mjetit të rëndë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 7 Nxënësi kryen punime të mirëmbajtjes dhe riparimit në sistemin e frenimit të mjetit të rëndë.

Kriteret e vlerësimit:

- të analizojë dokumentacionin teknik të sistemit të frenimit të mjetit të rëndë.
- të përgatitë vendin e punës për punime në sistemin e



- frenimit të mjetit.
- të përzgjedhë vegla, pajisje dhe instrumente për punime në sistemin e frenimit të mjetit.
- të marrë informacion paraprak për parregullsitë në sistemin e frenimit të mjetit.
- të vendosë automjetin në postin e punës.
- të kontrollojë funksionimin e elementeve të sistemit të frenimit, si dhe të bëjë përcaktimin e parregullsive.
- të bëjë çmontimin e pjesëve kryesore të sistemit të frenimit (frenat me tambur, frenat me ajër, mekanizmin hidraulik të komandimit të frenave, frenat e dorës).
- të bëjë çmontimin e detaleve të frenave me tambur, frenave me ajër, mekanizmit hidraulik të komandimit të frenave dhe frenave të dorës.
- të kontrollojë dhe të matë pjesët e çmontuara dhe të përcaktojë parregullsitë e tyre.
- të përzgjedhë pjesët e duhura për zëvendësim.
- të bëjë montimin e detaleve të zëvendësuar të frenave me tambur, frenave me ajër, mekanizmit hidraulik të komandimit të frenave dhe frenave të dorës.
- të bëjë montimin e pjesëve kryesore të sistemit të frenimit (frenat me tambur, frenat me ajër, mekanizmin hidraulik të komandimit të frenave, frenat e dorës).
- të kryejë grasatime.
- të bëjë regjistrimet e duhura në sistemin e frenimit.
- të bëjë kontrollin e funksionimit të sistemit të frenimit të riparuar.
- të kryejë prova në ecje të sistemit të frenimit të mjetit të rëndë.
- të përdorë dokumentacionin teknik (katalogëve) për të përzgjedhur pjesët e sistemit të frenimit që do të zëvendësohen..
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për shërbimet e kryera
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemit të frenimit të mjetit të rëndë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e shkollës për shërbime xhenerike ose në servise private të mjeteve të rënda.
 - Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të punimeve për shërbimet xhenerike të mjeteve të rënda.
 - Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për
-

kryerjen e punimeve të matjes, kontrollit, riparimit, zëvendësimit dhe provës së pjesëve xhenerike, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë praktike që kryejnë.

- Instruktori duhet të përdorë metodën e simulimit të parregullsive në pjesët xhenerike të mjeteve të rënda.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për kryerjen e shërbimeve të pjesët xhenerike të mjeteve.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Repart pune për shërbime xhenerike të automjeteve.
 - Mjete në gjendje pune.
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për matje, kontrole, zëvendësime dhe riparime të pjesëve të xhenerike.
 - Pjesë këmbimi për transmissionin e fuqisë së automjeteve.
 - Pjesë këmbimi për kutinë automatike të shpejtësisë së automjeteve
 - Pjesë këmbimi për rrotat dhe sistemin e varjes së automjeteve.
 - Pjesë këmbimi për sistemin e drejtimit të automjeteve.
 - Pjesë këmbimi për sistemin e frenimit të automjeteve.
 - Lubrifikuesa, alkool frenash.
 - Katalogë të pjesëve të sistemeve xhenerike, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

3. Moduli “Shërbimet e karrocerisë në mjetet e rënda të transportit”

Drejtimi: Shërbime mjeteshe transporti
Profili: Shërbime në mjetet e rënda të transportit
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	SHËRBIMET E KARROCERISË NË MJETET E RËNDA TË TRANSPORTIT	M-18-1329-16
-------------------------	---	---------------------

Qëllimi i modulit Një modul që aftëson nxënësit për të kryer punime të diagnostikimit, mirëmbajtjes dhe riparimit në karrocëritë e mjeteve të rënda të transportit.

Kohëzgjatja e modulit 84 orë mësimore

Niveli i parapëlqyer për pranim Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Shërbime mjeteshe transporti”.

Rezultatet e të mësuarit (RM), dhe procedurat e vlerësimit **RM 1** **Nxënësi kryen punime të zmontimit e montimit në karrocëritë e mjeteve të rënda të transportit.**
Kriteret e vlerësimit:
Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë dokumentacionin teknik të mjetit të rëndë.
- të përgatitë vendin e punës për punime në karrocëritë e mjeteve të rënda të transportit
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe instrumentet për punime në karrocëritë
- të vendosë në mënyrë të sigurtë mjete të rënda në postin e punës.
- të bëjë zmontimin e montimin e dyerve.
- të bëjë zmontimin e montimin e mbulesës së motorit (kofanos).
- të bëjë zmontimin e montimin e kapakut të bagazhit.
- të bëjë zmontimin e montimin e parakolpove.
- të bëjë zmontimin e montimin e parafangove.
- të bëjë zmontimin e montimin e maskarinos.
- të bëjë zmontimin e montimin e ndenjësive.
- të bëjë zmontimin e montimin e kroskotit.
- të bëjë zmontimin e montimin e veshjeve të brendshme të kabinës.
- të bëjë zmontimin e montimin e aksesorëve.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zmontimit e montimit të pjesëve të

karrocerisë të mjetit të rëndë

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Nxënësi kryen saldimin me hark elektrik të pjesëve të dëmtuara të karrocerisë.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të bëjë përgatitjen e bangos dhe vendosjen e pjesë për saldimin me hark elektrik në bango (nëse saldimi do të kryhet në bango).
- të zbatojë teknikat e saldimit me hark elektrik të pjesëve të thyera të karrocerisë (drejtimin e copave të thyera, përgatitjen e buzëve për saldim, realizimin e tegelit të saldimit, punimin përfundimtar të tegelit).
- të zbatojë teknikat e saldimit me hark elektrik të pjesëve të plasaritura të karrocerisë (drejtimin e copës së deformuar, përgatitjen e zonës së plasarit, realizimin e tegelit të saldimit, punimin përfundimtar të tegelit).
- të zbatojë teknikat saldimit me hark elektrik të pjesëve të dëmtuara prej llamarine (drejtimin e pjesëve të deformuara, përgatitjen e zonës së dëmtuar, realizimin e tegelit të saldimit, punimin përfundimtar të tegelit).
- të kryejë matjen dhe kontrollin e cilësisë së saldimit.
- të kryejë montimin e pjesës së riparuar në karroceri (kur është çmontuar më parë).
- të përgatitë dokumentacionin teknik dhe financiar të punës së kryer.
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë saldimit me hark elektrik të pjesëve të dëmtuara të karrocerisë së mjetit të rëndë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi kryen saldimin me gas të pjesëve të dëmtuara të karrocerisë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të bëjë përgatitjen e bangos dhe vendosjen e pjesës për saldimin me gas në bango (nëse saldimi do të kryhet në bango).
- të zbatojë teknikat e saldimit me gas të pjesëve të thyera të karrocerisë (drejtimin e copave të thyera, përgatitjen e buzëve për saldim me gas, realizimin e tegelit të saldimit, punimin përfundimtar të tegelit).
- të zbatojë teknikat e saldimit me gas të pjesëve të plasaritura të karrocerisë (drejtimin e copës së deformuar, përgatitjen e zonës së plasarit, realizimin e tegelit të saldimit me gas,

- punimin përfundimtare të tegelit).
- të zbatojë teknikat saldimit me gas të pjesëve të dëmtuara prej llamarine (drejtimin e pjesëve të deformatuara, përgatitjen e zonës së dëmtuar, realizimin e tegelit të saldimit me gas, punimin përfundimtar të tegelit).
- të kryejë matjen dhe kontrollin e cilësisë së saldimit me gas.
- të kryejë montimin e pjesës së riparuar në karroceri (kur është çmontuar më parë).
- të përgatitë dokumentacionin teknik dhe financiar të punës së kryer.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë saldimit me gas të pjesëve të dëmtuara të karrocervisë së mjetit të rëndë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Nxënësi kryen riparimin e pjesëve metalike të karrocervisë me anë të ngjitjes.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të karrocervisë.
- të përzgjedhë instrumentat dhe aparatet matëse dhe kontrolluese të duhura.
- të bëjë kontrollin e pjesës së dëmtuar të karrocervisë dhe të përcaktojë shkallën e dëmtimit.
- të bëjë zmontimin e pjesës (detalit) metalike të dëmtuar të karrocervisë (nëse është e nevojshme).
- të përcaktojë hapat e duhura për riparimin me ngjitje të pjesës së dëmtuar.
- të përzgjedhë dhe përgatitë pajisjen e duhur për ngjitjen.
- të përzgjedhë materialet dhe veglat e nevojshme për të kryer procesin e ngjitjes
- të bëjë parapërgatitjen e detalit të dëmtuar për ngjitje
- të vendosë detalin e dëmtuar në pajisjen shtrënguese (në bango).
- të përgatitë materialin për ngjitjen
- të kryejë procesin e ngjitjes të detalit metalik.
- të bëjë punimin përfundimtar të pjesës së ngjitur të detalit.
- të bëjë kontrollin e ngjitjes së detalit metalik.
- të bëjë montimin e detalit të riparuar në karroceri.
- të përgatitë dokumentacionin teknik dhe financiar të punës së kryer.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë riparimit të karrocervisë me anë të ngjitjes

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 5 Nxënësi riparon parakolpot, parafangot dhe maskarinot e shformuara.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të bëjë analizën e dokumentacionit teknik të karrocërisë.
- të bëjë zmontimin e parakolpit, parafangos dhe maskarinos së shformuar.
- të përzgjedhë instrumentat matëse, veglat dhe pajisjet për riparimin me shformim të parakolpit, parafangos dhe maskarinos.
- të bëjë kontrole dhe matje të sakta për përcaktimin e shkallës së shformimit.
- të përcaktojë hapat e duhura për riparimin me shformim të parakolpit, parafangos dhe maskarinos së shformuar.
- të bëjë nxehjen paraprake (nëse është e nevojshme) të parakolpit, parafangos dhe maskarinos, me pajisje termike.
- të bëjë riparimin me shformim të parakolpit, parafangos dhe maskarinos, me anë të pajisjeve përkatëse.
- të bëjë kontrollin dhe matjen përfundimtare të parakolpit, parafangos dhe maskarinos të riparuar me shformim.
- të bëjë montimin në karrocëri të parakolpit, parafangos dhe maskarinos, të riparuar me shformim.
- të përgatitë dokumentacionin teknik dhe financiar të punës së kryer.
- Të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë riparimit me shformim të parakolpit, parafangos dhe maskarinos.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 6 Nxënësi riparon dyert dhe mbulesat e motorit dhe bagazhit, të shformuara.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të karrocërisë.
- të bëjë zmontimin nga karrocëria të derës, mbulesës së motorit dhe të bagazhit, të shformuara.
- të përzgjedhë instrumentat dhe aparatet e duhura matëse dhe kontrolluese për shformimin e derës, mbulesës së motorit dhe të bagazhit.
- të bëjë kontrole dhe matje të sakta për përcaktimin e shkallës së shformimit.
- të përcaktojë hapat e duhura për riparimin me shformim të derës, mbulesës së motorit dhe të bagazhit shformuar.
- të përzgjedhë pajisjet dhe veglat e nevojshme për të kryer procesin e riparimit me shformim të derës, mbulesës së motorit dhe të bagazhit.

- të bëjë zmontimin e elementeve të derës, mbulesës së motorit dhe të bagazhit.
- të bëjë nxehjen paraprake të pjesës së shformuar (kur është e nevojshme)
- të bëjë riparimin me shformim të elementeve të shformuar të derës, mbulesës së motorit dhe të bagazhit, me anë të pajisjeve përkatëse.
- të bëjë kontrollin dhe matjen përfundimtare të elementëve të derës, mbulesës së motorit dhe të bagazhit, të riparuar me shformim.
- të përgatitë dokumentacionin teknik dhe financiar të punës së kryer.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë riparimit me shformim të derës, mbulesës së motorit dhe të bagazhit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 7 Nxënësi kryen stukimin dhe përpunimin përfundimtar të sipërfaqeve metalike të karrocerisë, që do të lyhen.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë gjëndjen e sipërfaqeve metalike pas përpunimit paraprak.
- të përzgjedh drejt instrumentat kontrollues.
- të përzgjedh drejt veglat dhe materialet e nevojshme që për stukimin dhe punimin mekanik përfundimtar.
- të kryejë saktë procesin e stukimit.
- të kryejë saktë zmerilimin përfundimtar.
- të kryejë saktë kontrollin e cilësisë së stukimit dhe punimit mekanik përfundimtar.
- të përzgjedhë vegla dhe pajisjet e duhura për pastrimin kimik.
- të përzgjedhë materialet dhe solucionet e duhura për pastrimin kimik.
- të përgatitë enën (vaskën) për pastrimin kimik.
- të përgatitë solucionin kimik për heqjen e oksideve nga sipërfaqja që do të lyhet.
- të bëjë zhytjen e pjesës së karrocerisë në enën për heqjen e oksideve.
- të përgatitë solucionin kimik për heqjen e yndyrnave nga sipërfaqja që do të lyhet.
- të bëjë zhytjen e pjesës së karrocerisë në enën për heqjen e yndyrnave (në rastin kur boja do të jetë e lëngëshme).
- të bëjë shplarjen e pjesës së karrocerisë nga mbeturinat e solucionit kimik.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit



gjatë stukimit dhe punimit mekanik përfundimtar të sipërfaqeve që do të lyhen.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e shërbimit të mjeteve të transportit ose në mjedise pune (servise) ku kryhen punime zmontimit dhe montimit të karrocive, punime të riparimit me shformim, punime të riparimit me ngjitje, punime të riparimit me anë të saldimit me gas e me hark elektrik të pjesëve metalike dhe plastike të karrocive të mjeteve të transportit.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të punimeve paraprake dhe kryesore të riparimit me shformim, punime të riparimit me ngjitje, të riparimit me anë të saldimit me gas e me hark elektrik të pjesëve metalike dhe plastike të karrocive të mjeteve të transportit.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për kontrollin, matjen dhe riparimin me shformim, saldim, ngjitje të pjesëve të karrocive të mjeteve të rënda të transportit, për kryerjen e punimeve paraprake mekanike, të stukimit, lyerjes, pjekjes dhe luçidimit të sipërfaqeve metalike të karrocive, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për kontrollin, matjen dhe riparimin të pjesëve të karrocive të mjeteve të rënda të transportit.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për matje, kontrole të pjesëve metalike të karrocive.
 - Mjedise të praktikës së zmontimit dhe montimit të karrocive të automjeteve, të riparimit me shformim të pjesëve të karrocive të mjeteve të transportit (në shkollë ose në servise reale).
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për matje, kontrole të pjesëve metalike të karrocive, për zmontimin dhe montimin e karrocive të automjeteve.
 - Automjete mësimore.
 - Pjesë të karrocive të automjeteve të rënda të transportit.
 - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

4. Moduli “Shërbimet në agregatet e mjeteve të rënda të transportit”

Drejtimi: Shërbime mjetes transporti
Profili: Shërbime në mjetet e rënda të transportit
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	SHERBIMET NE AGREGATET E MJETEVE TË RENDA TE TRANSPORTIT	M-18-1330-16
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer punime të diagnostikimit, mirëmbajtjes dhe riparimit në pjesën agregate të mjeteve të rënda të transportit.	
Kohëzgjatja e modulit	120 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Shërbime mjetes transporti”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi kryen punime të mirëmbajtjes dhe riparimit të kovës së agregatit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të analizojë dokumentacionin teknik të ndërtimit dhe funksionimit të kovës së agregatit.– të përgatitë vendin e punës për punime në nyjen e kovës së agregatit.– të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe instrumentet për punime në nyjen e kovës.– të marrë informacionin paraprak për parregullsitë në nyjen e kovës.– të kontrollojë dhe të provojë funksionimin e nyjes së kovës si dhe të përcaktojë parregullsitë.– të vendosë mjetin e rëndë në mënyrë të sigurtë në postin e punës.– të çmontojë lidhjet mekanike dhe hidraulike të nyjes së kovës me pjesët e tjera të agregatit.– të çmontojë nyjen e kovës nga automjeti dhe të pastrojë atë.– të vendosë kovën e çmontuar në vëndin e punës.– të çmontojë pjesët e shtytësit hidraulik.– të kryejë kontrolle pamore dhe matje të pjesëve të çmontuara për përcaktimin e saktë të shkallës së konsumimit ose të dëmtuara.– të përcaktojë mënyrën e riparimit të pjesëve të konsumuara apo të dëmtuara të nyjes së kovës (kova, shtytësi hidraulik	

dhe çernierat).

- të dërgoj në repartet përkatëse pjesët për riparim.
- të kryejë kontrollet e cilësisë pas riparimit të detaleve përkatëse.
- të kryejë montimin e shtytësit hidraulik.
- të kryejë montimi e nyjes së kovës.
- të bëjë provën e funksionimit të nyjes së kovës.
- të përdorë dokumentacionin teknik (katalogët) për të përzgjedhur pjesët e nyjes së kovës që do të zëvendësohen.
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mirëmbajtjes dhe riparimit të nyjes së kovës së agregatit..

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Nxënësi kryen punime të mirëmbajtjes dhe të riparimit të thikës (ruspës) së agregatit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë dokumentacionin teknik të ndërtimit dhe funksionimit të thikës së agregatit.
- të përgatitë vendin e punës për punime në nyjen e thikës së agregatit.
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe instrumentet për punime në nyjen e thikës.
- të marrë informacionin paraprak për parregullsitë në nyjen e thikës.
- të kontrollojë dhe të provojë funksionimin e nyjes së thikës si dhe të përcaktojë parregullsitë.
- të vendosë automjetin në mënyrë të sigurtë në postin e punës.
- të çmontojë lidhjet mekanike dhe hidraulike të nyjes së thikës me pjesët e tjera të agregatit
- të çmontojë nyjen e thikës nga automjeti dhe të pastrojë atë.
- të vendosë thikën e çmontuar në vëndin e punës.
- të çmontojë pjesët e shtytësit hidraulik.
- të kryejë kontrole pamore dhe matje të pjesëve të çmontuara për përcaktimin e saktë të shkallës së konsumimit ose të dëmtimit.
- të përcaktojë mënyrën e riparimit të pjesëve të konsumuara apo të dëmtuara të nyjes së thikës (thika, struktura mbajtëse, shtytësi hidraulik dhe çernierat).
- të dërgoj në repartet përkatëse pjesët për riparim.
- të kryejë kontrollet e cilësisë pas riparimit të detaleve përkatëse.

- të kryejë montimin e shtytësit hidraulik.
- të kryejë montimin e nyjes së thikës.
- të bëjë provën e funksionimit të nyjes së thikës.
- të përdorë dokumentacionin teknik (katalogët) për të përzgjedhur pjesët e nyjes së thikës që do të zëvendësohen.
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mirëmbajtjes dhe riparimit të nyjes së thikës së agregatit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 3 Nxënësi kryen punime të mirëmbajtjes dhe riparimit të krahut të punës së agregatit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë dokumentacionin teknik të nyjes së krahut të punës të agregatit.
- të përgatitë vendin e punës për punime në nyjen e krahut të punës së agregatit.
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe instrumentet për punime në nyjen e krahut të punës të agregatit.
- të marrë informacionin paraprak për parregullsitë në nyjen e krahut të punës së agregatit.
- të kontrollojë dhe të provojë funksionimin e nyjes së krahut të punës të agregatit si dhe të përcaktojë parregullsitë.
- të vendosë mjetin e rëndë në postin e punës.
- të çmontojë lidhjet mekanike dhe hidraulike që e lidhin krahun e punës me pjesët e tjera të agregatit.
- të çmontojë shtytësit hidraulik.
- të vendosë në postet e tyre të punës krahun e punës dhe shtytësit hidraulik.
- të kryejë kontrole pamore dhe matje të pjesëve të krahut të punës dhe shtytësve hidraulik, duke përcaktuar shkallën e konsumimit të tyre.
- të përcaktojë mënyrën e riparimit të tyre.
- të përzgjedhë elementët që do të zëvendësohen (permistopa, kapak, gomina etj.).
- të kontrollojë cilësinë pas riparimit.
- të montojë nyjen e krahut të punës me pjesët e tjera të agregatit.
- të bëjë lubrifikimin e çernierave lidhëse.
- të kryejë provën e funksionimit të nyjes së krahut të punës së agregatit.
- të përdorë dokumentacionin teknik (katalogët) për të përzgjedhur pjesët e nyjes së krahut të punës që do të zëvendësohen.
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës.

- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mirëmbajtjes dhe riparimit të krahut të punës të agregatit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Nxënësi kryen punime të mirëmbajtjes dhe riparimit të kollonës së agregatit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë dokumentacionin teknik të kollonës së agregatit.
- të përgatitë vendin e punës për punime në kollonën e agregatit.
- të përzgjedhë vegla, pajisje dhe instrumente për punime në kollonën e agregatit.
- të marrë informacionin paraprak për parregullsitë në kollonën e agregatit.
- të kontrollojë dhe të provojë funksionimin e kollonës së agregatit dhe të përcaktojë parregullsitë.
- të vendosë mjetin e rëndë në postin e punës.
- të çmontojë kollonën e agregatit nga lidhjet me platformën dhe krahun e punës.
- të çmontojë ngritësat hidraulik.
- të kryejë kontrolle pamore dhe matje të pjesëve të çmontuara për përcaktimin e saktë të parregullsive si dhe shkallën e konsumimit.
- të përcaktojë mënyrën e riparimit të pjesëve të dëmtuara.
- të zëvendësojë dhe të montojë pjesë që nuk riparohen.
- të montojë kollonën dhe ngritësat hidraulik.
- të kryejë kontrollin e lëngut hidraulik, si dhe të bëjë zëvendësimin e sasisë së humbur.
- të kryejë provën e funksionimit të nyjes së kollonës.
- të përdorë dokumentacionin teknik (katalogët) për të përzgjedhur pjesët e nyjes së kollonës që do të zëvendësohen.
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mirëmbajtjes dhe riparimit të nyjes së kollonës së agregatit..

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 5 Nxënësi kryen punime të mirëmbajtjes dhe riparimit në sistemin e shpërndarjes së lëngut (vajit) hidraulik.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë dokumentacionin teknik të sistemit të shpërndarjes së lëngut hidraulik.
- të përgatitë vendin e punës për punime në sistemin e shpërndarjes së lëngut hidraulik.
- të përzgjedhë vegla, pajisje dhe instrumente për punime në sistemin e shpërndarjes së lëngut hidraulik.
- të marrë informacionin paraprak për parregullsitë në sistemin e shpërndarjes së lëngut hidraulik.
- të kontrollojë dhe të provojë funksionimin e sistemit të shpërndarjes së lëngut hidraulik, si dhe të përcaktojë parregullsitë.
- të vendosë mjetin e rëndë në postin e punës.
- të zbrazë vazin nga sistemi shpërndarës.
- të ndajë pompën hidraulike, shpërndarësit si dhe tubacionet nga njëri tjetri.
- të çmontojë pompën.
- të çmontojë shpërndarësit.
- të çmontojë tubacionet.
- të kryejë kontrolle pamore dhe matje të pjesëve të çmontuara për përcaktimin e saktë të parregullsive në pompë.
- të zëvendësoj dhe të montojë pjesë e konsumuara të pompës.
- të kryejë kontrolle pamore dhe matje të pjesëve të çmontuara shpërndarësve për përcaktimin e saktë të parregullësive në shpërndarës.
- të zëvendësojë shpërndarësit e konsumuar.
- të kryejë kontrolle pamore dhe matje të tubacioneve të transmetimit të lëngut hidraulik.
- të zëvendësojë tubacionet e konsumuara.
- të kryejë provën e funksionimit të pompës dhe të shpërndarësve.
- të përdorë dokumentacionin teknik (katalogët) për të përzgjedhur pjesët e konsumuara të pompës, shpërndarësit si dhe tubacionet e transmetimit të lëngut hidraulik.
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemit shpërndarës të lëngut hidraulik.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 6 Nxënësi kryen veprimet përfundimtare të shërbimit dhe riparimit të agregateve të automjeteve të rënda të transportit.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të bëjë llogaritjen e shpenzimeve për materialet.



- të bëjë llogaritjen e shpenzimeve për punën e kryer.
- të bëjë llogaritjen e kostos së plotë dhe të çmimit të shërbimit të kryer.
- të bëjë plotësimin e dokumentacionit financiar për shërbimin e kryer.
- të bëjë plotësimin e dokumentacionit teknik për shërbimin e kryer.
- të përgatitë mjetine rëndë për dorëzim te klienti.
- të bëjë udhëzimin e klientit dhe dorëzimin e mjetit të rëndë.
- të përdorë dokumentacionin teknik (katalogëve) për të përzgjedhur pjesët që zëvendësohen.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e shkollës për shërbime të aggregateve ose në servise private të mjeteve të rënda.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të punimeve për shërbimet e pjesës aggregate të mjeteve të rënda.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve të matjes, kontrollit, riparimit, zëvendësimit dhe provës së pjesës aggregate, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë praktike që kryejnë.
- Instruktori duhet të përdorë metodën e simulimit të parregullsive në pjesën aggregate.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për kryerjen e shërbimeve në pjesën aggregate të mjeteve të rënda.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Repart pune për shërbime të pjesës aggregate të mjeteve të rënda.
 - Mjete të rënda në gjendje pune.
 - Kompleti i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për matje, kontrolle, zëvendësime dhe riparime të pjesës aggregate të mjeteve të rënda.
 - Pjesë këmbimi për pjesën aggregate të mjeteve të rënda.
 - Lubrifikues.
 - Katalogë për pjesë aggregate të mjeteve të rënda, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar

1. Moduli “Shërbimet në vinçat hidraulikë të montuar në mjetet e rënda të transportit”

Drejtimi: Shërbime mjetesh transporti
Profili: Shërbime në mjetet e rënda të transportit
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	SHËRBIMET NË VINÇAT HIDRAULIKË TË MONTUAR NË MJETET E RËNDA TË TRANSPORTIT	M-18-1331-16
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer punime të mirëmbajtjes dhe të riparimit në vinçat hidraulikë të montuar në mjetet e rënda të transportit.	
Kohëzgjatja e modulit	102 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Shërbime mjetesh transporti”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi kryen punime përgatitore për shërbimin në vinçat hidraulikë të montuar në mjetet e rënda të transportit. Kriteret e realizimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë : <ul style="list-style-type: none">– të analizojë dokumentacionin teknik teknik të mjetit dhe vinçit hidraulik të montuar për ngritje.– të përgatitë vendin e punës për punime në në vinçat hidraulik të montuar në mjetet e rënda të transportit.– të përzgjedhë veglat, pajisjet, instrumentet dhe materialet për punime në vinçat hidraulik të montuar në mjetet e rënda të transportit.– të përzgjedhë instrumentet dhe pajisjet matëse dhe kontrolluese.– të vendosë mjetin me vinç hidraulik të montuar për ngritje në mënyrë të sigurtë në postin e punës.– të marrë informacionin paraprak për parregullsitë në vinçat hidraulik të montuar në mjetet e rënda të transportit.– të ndezë mjetin e rëndë dhe të aktivizojë sistemin hidraulik të vinçit për ngritje.– të hapë krahët me stabilizatorë dhe të vendosë mjetin në ekuilibër.	

-
- të bëjë kontrollin pamor dhe dëgjimor të elementeve të sistemit të vendosjes së mjetit në ekuilibër.
 - të kontrollojë sinjalistikën manaxhuese.
 - të bëjë kontrollin pamor dhe dëgjimor për parregullsi në vinçat hidraulikë të montuar në mjetet e rënda të transportit.
 - të kontrollojë bashkimin e bazamentit me strukturën e mjetit si dhe të suportit të kollonës rrotulluese.
 - të bëjë kontrollin e kollonës dhe mekanizmit rrotullues me kremalier.
 - të kontrollojë grupin e krahëve teleskopikë dhe fiks si dhe të zgjatuesve manual.
 - të kontrollojë cilindrat hidraulikë, bashkimet hidraulike si dhe rrugën e fluidit (vajit hidraulik) punues.
 - të kontrollojë saktësinë e bashkimi të akseve gjeometrike të boshtit rrotullues të sistemit hidraulik me boshtin rrotullues të motorit lëvizdhënës (boshtit motorik).
 - të bëjë kontrole dhe matje të detajuara të parametrave të parapërcaktuar (presionin, prurjen, shpejtësin, temperaturën, viskozitetin, dendësinë)
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë parapërgatitjes për shërbimin në vinçat hidraulik të montuar në mjetet e rënda të transportit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Nxënësi kryen punime të mirëmbajtjes në vinçat hidraulikë të montuar në mjetet e rënda të transportit.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të përzgjedhë veglat, instrumentet dhe pajisjet për të bërë mirëmbajtjen në vinçat hidraulikë të montuar në mjetet e rënda të transportit.
- të përzgjedhë materialet dhe pjesët e këmbimit për mirëmbajtjen në vinçat hidraulikë të montuar në mjetet e rënda të transportit.
- të pastrojë papastërtitë në vinçat hidraulik të montuar në mjetet e rënda të transportit.
- të pastrojë aksesorët, pajisjet e komandimit, pajisjet e sinjalizimit dhe të sigurisë.
- të kryejë rimbushjen e fluidit punues nëse ka rënë niveli.
- të kryejë grasatime në vendet e përcaktuara.
- të kryejë shtrëngime dhe regjistrime të nevojshme në mekanizmat dhe sistemet.
- të kryejë procedurat e kontrollit të mekanizmit rrotullues me kremalier.
- të kryejë procedurat e kontrollit të presionit me ngarkesë dhe pa ngarkesë.

- të kryejë procedurat e pastrimit të serbatorit të fluidit punues dhe valvulës shkarkuese të tij.
- të kryejë procedurat e zëvendësimit të fluidit punues.
- të kryejë procedurat e zëvendësimit të bllokuesve mekanikë
- të kryejë procedurat e zëvendësimit të ganxhës kapëse për ngritje dhe aksesoreve të saj, si dhe pername bllokuese.
- të kryejë procedurat e zëvendësimit të pompës, cilindrave punues, të shpërndarësve ose valvolave kufizuese dhe bllokuese.
- të kryejë procedurat e zëvendësimit të tubave përcjellës dhe elementeve ndërlidhës.
- të kryejë procedurat e zëvendësimit të levave komanduese dhe butonit të emergjencës.
- të kryejë provat e funksionimit të vinçit hidraulik të montuar në mjetet e rënda të transportit pas kryerjes së punimeve të mirëmbajtjes.
- të kujdeset për vendin dhe mjetet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë shërbimit të mirëmbajtjes në vinçat hidraulik të montuar në mjetet e rënda të transportit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi kryen punime të riparimit në vinçat hidraulikë të montuar në mjetet e rënda të transportit.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë veglat, instrumentet dhe pajisjet për të bërë riparimin në vinçat hidraulikë të montuar në mjetet e rënda të transportit
- të përzgjedhë materialet dhe pjesët e këmbimit për riparimin e vinçave hidraulikë të montuar në mjetet e rënda të transportit.
- të kryejë procedurat e çmontimit të lidhjes me mekanizmin kardanic (boshtin motorik).
- të kryejë procedurat e zëvendësimit të pjesëve të sistemit hidraulik.
- të kryejë procedurat e zëvendësimit të pompës hidraulike dhe pjesëve të lidhura me të.
- të kryejë procedurat e zëvendësimit të valvolës për kufizim të presionit të pompës.
- të kryejë procedurat e zëvendësimit të serbatorit të fluidit punues hidraulik.
- të kryejë procedurat e zëvendësimit të valvulës së shkarkimit të presionit të serbatorit të fluidit (vajit) punues hidraulik.
- të kryejë procedurat e zëvendësimit të tubave fleksibël.
- të kryejë procedurat e zëvendësimit të cilindrave punues



- dhe të pjesëve të lidhura me to.
- të kryejë procedurat e zëvendësimit të cilindrave teleskopikë.
- të kryejë procedurat e zëvendësimit të valvolave bllokuese të cilindrave punues dhe teleskopik.
- të kryejë procedurat e zëvendësimit të tubacioneve dhe rakordeve lidhëse të sistemit të qarkullimit të fluidit punues.
- të kryejë procedurat e zëvendësimit të sistemit të stabilizimit dhe qëndrueshmërisë.
- të kryejë procedurat e zëvendësimit të pjesëve të krahëve horizontalë teleskopikë (me komandim manual dhe hidraulik).
- të kryejë procedurat e zëvendësimit të pjesëve vertikale të mbështetjes (cilindrat ose pistonat teleskopikë).
- të kryejë procedurat e zëvendësimit të pjesës mbështetëse me terrenin.
- të kryejë procedurat e montimit të sistemit hidraulik në vinçat hidraulik të montuar në mjetet e rënda të transportit.
- të kryejë procedurat e montimit të sistemit të stabilizimit dhe qëndrueshmërisë.
- të kryejë provat në vinçat hidraulik të montuar në mjetet e rënda të transportit pas kryerjes së punimeve të riparimit.
- të kujdeset për vendin dhe mjetet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë shërbimit të riparimit të vinçave hidraulikë të montuar në mjetet e rënda të transportit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Nxënësi kryen veprimet përfundimtare të shërbimit në vinçat hidraulikë të montuar në mjetet e rënda të transportit.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të bëjë llogaritjen e shpenzimeve për materialet.
- të bëjë llogaritjen e shpenzimeve për punën e kryer.
- të bëjë llogaritjen e kostos së plotë dhe të çmimit të shërbimit të kryer për për vinçat hidraulikë të montuar në mjetet e rënda të transportit.
- të bëjë plotësimin e dokumentacionit financiar për shërbimin e kryer.
- të bëjë plotësimin e dokumentacionit teknik për shërbimin e kryer.
- të përgatitë mjetin me me vinç hidraulik të montuar për dorëzim te klienti.
- të bëjë udhëzimin e klientit dhe dorëzimin e mjetit me me vinç hidraulik.



- të përdorë dokumentacionin teknik (katalogët) për të për zgjedhur pjesët që zëvendësohen te vinçat hidraulikë të montuar në mjetet e rënda.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e shkollës për shërbime në mjetet e rënda të transportit, ose në servise private të mjetet e rënda të transportit (kamiona)
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të punimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit në vinçat hidraulikë të montuar në mjetet e rënda të transportit.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve të matjes, kontrollit, mirëmbajtjes, riparimit, zëvendësimit dhe provës së funksionimit në vinçat hidraulik të montuar në mjetet e rënda të transportit, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë praktike që kryejnë.
- Instruktori duhet të përdorë metodën e simulimit të parregullsive në vinçat hidraulik të montuar në mjetet e rënda të transportit.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit në vinçat hidraulik të montuar në mjetet e rënda të transportit
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Repart pune për shërbime në mjetet e rënda të transportit.
 - Vinç hidraulik të montuar në mjetet e rënda të transportit në gjendje pune.
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për matje, kontrolle, zëvendësime dhe riparime të vinçat hidraulikë të montuar në mjetet e rënda të transportit
 - Pjesë këmbimi dhe materiale të nevojshme për mirëmbajtjen dhe riparimet vinçat hidraulik të montuar në mjetet e rënda të transportit.
 - Lubrifikues.
 - Katalogë të vinçave hidraulikë të montuar në mjetet e rënda të transportit.
 - Manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

2. Moduli “Shërbimet në sistemin hidraulik për ngritje të platformës të kamionit”

Drejtimi: Shërbime mjetesht transporti
Profili: Shërbime në mjetet e rënda të transportit
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	SHËRBIMET NË SISTEMIN HIDRAULIK PËR NGRITJE TË PLATFORMËS TË KAMIONIT	M-18-1332-16
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer punime të mirëmbajtjes dhe të riparimit në sistemin hidraulik për ngritje të platformës të kamionit.	
Kohëzgjatja e modulit	102 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Shërbime mjetesht transporti”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi kryen punime përgatitore për shërbimin në sistemin hidraulik për ngritje të platformës të kamionit. Kriteret e realizimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë : <ul style="list-style-type: none">– të analizojë dokumentacionin teknik të kamionit dhe sistemit hidraulik për ngritje të platformës.– të përgatitë vendin e punës për punime në sistemin hidraulik për ngritje të platformës.– të përzgjedhë veglat, pajisjet, instrumentet dhe materialet për punime në sistemin hidraulik për ngritje të platformës.– të përzgjedhë veglat, instrumentat dhe pajisjet matëse dhe kontrolluese.– të vendosë kamionin me sistem hidraulik për ngritje, në mënyrë të sigurtë në postin e punës– të marrë informacionin paraprak për parregullsitë në sistemin hidraulik për ngritje të platformës të kamionit.– të ndezë kamionin dhe aktivizojë sistemin hidraulik për ngritje.– të bëjë kontrollin pamor dhe dëgjimor për parregullsi në sistemin hidraulik për ngritje të platformës.– të kontrollojë saktësinë e bashkimit të akseve gjeometrike të boshtit rrotullues të sistemit me boshtin rrotullues të motorit lëvizdhënës (boshtin motorik).– të kontrollojë rrugën e fluidit (vajit) punues– të bëjë kontrole dhe matje të detajuara të parametrave të parapërcaktuar (presionin, prurjen, shpejtësin, temperaturën, viskozitetin, dendësinë	

-
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë parapërgatitjes për shërbimin e sistemit hidraulik për ngritje të platformës

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Nxënësi kryen punime të mirëmbajtjes së sistemit hidraulik për ngritje të platformës së kamionit.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të përzgjedhë veglat, instrumentet dhe pajisjet për të bërë mirëmbajtjen e sistemit hidraulik për ngritje të platformës
- të përzgjedhë materialet dhe pjesët e këmbimit për mirëmbajtjen e sistemit hidraulik për ngritje të platformës.
- të pastrojë nga kavitacionet dhe papastërtitë, sistemin nga jashtë.
- të pastrojë filtrin dhe të kryejë ndërrimin e elementit punues në filtër.
- të kryejë rimbushjen e fluidit punues nëse ka rënë niveli.
- të kryejë grasatime në vendet e përcaktuara.
- të kryejë shtrëngime dhe regjistrime të nevojshme në mekanizmat dhe sistemet.
- të kryejë procedurat e zëvendësimit të fluidit punues.
- të kryejë procedurat e zëvendësimit të filtrave të fluidit punues.
- të kryejë procedurat e zëvendësimit të pompës, hidromotorit, cilindrave punues, shpërndarësve ose valvolave.
- të kryejë procedurat e zëvendësimit të tubave përcjellës dhe elementeve lidhës.
- të kryejë provat e funksionimit të sistemit hidraulik për ngritje të platformës pas kryerjes së punimeve të mirëmbajtjes.
- të kujdeset për vendin dhe mjetet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit hidraulik për ngritje të platformës

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi kryen punime të riparimit në sistemin hidraulik për ngritje të platformës të kamionit.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të përzgjedhë veglat, instrumentet dhe pajisjet për të bërë riparimin e sistemit hidraulik për ngritje të platformës.
- të përzgjedhë materialet dhe pjesët e këmbimit për riparimin

- e sistemit hidraulik për ngritje të platformës.
- të kryejë procedurat e çmontimit të lidhjes me mekanizmin kardanic (boshtin motorik).
- të kryejë procedurat e zëvendësimit të pompës hidraulike dhe pjesëve të lidhura me të.
- të kryejë procedurat e zëvendësimit të valvolës për kufizim të presionit të pompës.
- të kryejë procedurat e zëvendësimit të hidromotorit dhe pjesëve të lidhura me të.
- të kryejë procedurat e zëvendësimit të cilindrave punues dhe të pjesëve të lidhura me to.
- të kryejë procedurat e zëvendësimit të pjesëve të sistemit të qarkullimit të fluidit punues.
- të kryejë procedurat e zëvendësimit të rezervuarit të fluidit punues.
- të kryejë procedurat e zëvendësimit të pjesëve të shpërndarësve.
- të kryejë procedurat e zëvendësimit të të rubinetit me levë.
- të kryejë procedurat e montimit të sistemit hidraulik për ngritje të platformës në kamion.
- të kryejë provat të sistemit hidraulik për ngritje të platformës pas kryerjes së punimeve të riparimit.
- të kujdeset për vendin dhe mjetet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë shërbimit të riparimit të sistemit hidraulik për ngritje të platformës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Nxënësi kryen veprimet përfundimtare të shërbimit në sistemin hidraulik për ngritje të platformës të kamionit.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të bëjë llogaritjen e shpenzimeve për materialet.
- të bëjë llogaritjen e shpenzimeve për punën e kryer.
- të bëjë llogaritjen e kostos së plotë dhe të çmimit të shërbimit të kryer për sistemin hidraulik për ngritje të platformës të kamionit.
- të bëjë plotësimin e dokumentacionit financiar për shërbimin e kryer.
- të bëjë plotësimin e dokumentacionit teknik për shërbimin e kryer.
- të përgatitë kamionin me sistem hidraulik për ngritje të platformës, për dorëzim te klienti.
- të bëjë udhëzimin e klientit dhe dorëzimin e kamionit.
- të përdorë dokumentacionin teknik (katalogët) për të përzgjedhur pjesët e e sistemit hidraulik për ngritje të platformës të kamionit që zëvendësohen.



- të tregojë kujdesin e duhur për vendin, veglat dhe pajisjet e punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e shkollës për shërbime në mjetet e rënda të transportit, ose në servise private të mjetet e rënda të transportit (kamion)
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të punimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemit hidraulik për ngritje të platformës të kamionit.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve të matjes, kontrollit, mirëmbajtjes, riparimit, zëvendësimit dhe provës së funksionimit të sistemit hidraulik për ngritje të platformës të kamionit, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë praktike që kryejnë.
- Instruktori duhet të përdorë metodën e simulimit të parregullsive në sistemin hidraulik për ngritje të platformës të kamionit.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemit hidraulik për ngritje të platformës të kamionit.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Repart pune për shërbime në mjetet e rënda të transportit.
 - Kamion me sistem hidraulik për ngritje të platformës.
 - Kompleti i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për matje, kontrolle, zëvendësime dhe riparime të sistemit hidraulik për ngritje të platformës të kamionit.
 - Pjesë këmbimi dhe materiale të nevojshme për mirëmbajtjen dhe riparimin e sistemit hidraulik për ngritje të platformës të kamionit.
 - Lubrifikues.
 - Katalogë të sistemit hidraulik për ngritje të platformës të kamionit.
 - Manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-